



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

RAPORTI VJETOR 2023

Oda e Mjekëve të Kosovës



Shkurt 2024, Prishtinë

Përmbajtja:

RAPORTI VJETOR 2023	1
1. Infrastruktura juridike	3
2. Këshilli Drejtues	3
3. Anëtarësimi	3
4. Mbikëqyrja etiko-profesionale	5
5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	8
6. Licencimet.....	8
7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi 9dhe Ligjin për OPSH-të	9
8. Këshilli Mbikëqyrës	9
9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	9
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së	10
11. Raporti financiar	11
11.1 Raporti financiar deri me 31 dhjetor 2023	11
11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	12
11.3 Prokurimi	14
12. Aktivitete të tjera	15
12.1 Oda e Mjekëve të Kosovës - 10 Vite punë dhe përkushtim	15
12.2 Zgjedhjet për legjislaturën e III-të të OMK-së.....	16
12.3 Kongresi i V i Mjekësisë - Risitë në trajtimin e sëmundjeve 16 kardiovaskulare.....	16
12.4 Botimi i “Revista Mjeku”	17
12.5 Marrëveshja për delegimin e fondeve dhe implementim	17
12.6 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së	20

12.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	20
12.8 Marrëdhëniet ndërkombëtare.....	21
13. Plani i veprimit për 2024	23

1. Infrastruktura juridike

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës gjatë vitit 2023 ka mbajtur dy mbledhje të rregullta. Mbledhjen e datës 15 shkurt dhe 26 dhjetor, ku janë bërë edhe dhënia e betimit nga përfaqësuesit e rinj të njësive zgjedhore atë të Spitalit të Përgjithshëm të Vushtrrisë dhe Klinikës së Gjinekologjisë. Gjithashtu u miratuan rregulloret dhe amendamentet për plotësim dhe ndryshim të akteve normative si në vijim:

- Amendamentet për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional;
- Amendamentet për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së Komisionit të Anëtarësimit, Licencimit dhe Rilicencimit;
- Amendamentet për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Menaxhimin e Financave të OMK-së;
- Amendamentet për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për Procedurat e Prokurimit të OMK-së;
- Amendamentet për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për përcaktimin e shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyrjes etike;


2. Këshilli Drejtues

Gjatë vitit 2023, Këshilli Drejtues i OMK-së ka mbajtur 12 takime, si dhe në 8 raste kanë votuar elektronikisht përmes e-mailit, ku janë pranuar 35 lëndë, nga të cilat janë marr 67 vendime sipas kërkesave/ankesave të pranuar.


3. Anëtarësimi

Anëtarësimi në Odën e Mjekëve të Kosovës ka filluar më datë 23 janar 2018. Gjatë vitit 2023 janë anëtarësuar 328 mjekë, ku si rezultat numri total ka arritur në 5275 mjekë, ku 3708 mjekë janë të punësuar në sektorin publik, 847 mjekë në sektorin privat, 111 mjekë pensionist dhe 609 mjekë të papunë. Pas verifikimit me Ministrinë e Financave, numri i mjekëve të papunë me datë 31.12.2023, është 441. Pra, 168

mjekë janë në marrëdhënie pune por të cilët nuk i kanë përditësuar të dhënat në regjistrin e anëtarësisë në Odë.



Grafikoni 1. Anëtarësimet deri me 31 dhjetor 2023



Grafikoni 2. Anëtarët e ndarë sipas moshës.

Bazuar në tabelën më lartë shihet se mosha mesatare e mjekëve anëtarë është 47 vjeç, anëtari më i ri është 24 vjeç, kurse anëtari më i vjetër është 88 vjeç.

4. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë organeve të Odës, në mënyrë tabelore do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e organeve të Odës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2023	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2023	Sanksionet e shqiptuara për vitin 2023	Sanksionet e ekzekutuara për vitin 2023	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	63	42	12	10	20
Këshilli Etik	47	30*	Rekomandime kolegjiale 12 Qortime publike 3	Rekomandim e kolegjiale 10 Qortime publike 3	15
Gjyqi i Nderit	5	5	///	///	0
Certifikatat e të kaluarës etike	1261**	///	///	///	///


*Në Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për vitin 2023 janë të përfshira edhe vendimet e nxjerra për lëndët e bartura nga viti 2022.

Këshilli Etik në shqyrtim të drejtpërdrejtë, ka mbajtur nëntë seanca të shqyrtimit kryesor, në të cilat është mundësuar përfaqësimi i drejtpërdrejt i palëve në procedurë, përfshirë të drejtën në përfaqësues me autorizim (prokurë).


**Gjatë vitit 2023, janë lëshuar 1261 certifikata për të kaluarën etike, ku 1094 certifikata janë lëshuar për mjekët që kanë marr certifikata për shtesat mbi pagë në sektorin publik Rregullorja nr. 02/2023, dhe mjekët që kanë marr certifikata edhe viteve të kaluara.

Ndërsa, 167 certifikata janë lëshuar për mjekët që janë pajisur me certifikata për përdorim jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Prej tyre 149 certifikata janë lëshuar për Doktor të Mjekësisë, 13 certifikata për mjekët në shkollim specialistik kurse 5 certifikata janë lëshuar për specialist.


Mosha mesatare e mjekëve që janë pajisur me certifikata është 28 vjeç. Prej tyre 85 mjekë janë meshkuj dhe 82 janë femra.



Grafikoni 3. Certifikata për të kaluarën etike deri me 31 dhjetor 2023.



Grafikoni 4. Mosha e mjekëve që kanë marrë certifikatë për të kaluarën etike



Grafikoni 5. Data e diplomimit të mjekëve që kanë marrë certifikatë për të kaluarën etike.

Gjatë vitit 2023 nga numri total i mjekëve që kanë kërkuar certifikata për të kaluarën etike, janë 140 mjekë apo 84% e të cilët kanë diplomuar në katër vitet e fundit.


5. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional gjatë vitit 2023, ka akredituar 197 aktivitete. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, 12 shoqata kanë bërë kërkesë për përkrahje financiare për organizimin e aktiviteteve, 3 nga kërkesat janë refuzuar për përkrahje financiare kurse 9 kërkesa janë aprovuar nga Komisioni.



6. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe ri-licencim profesional gjatë vitit 2023, ka organizuar 7 provime të rilicencimit dhe gjithashtu ka lëshuar 1190 licenca me kategoritë si në grafikun e më poshtëm:



Nga data e bartjes së kompetencës për licencim, ky komision i ka lëshuar gjithsej 10057 licenca.

7. Edukimi specialistik-zbërthimi i kompetencës bazuar në Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin për OPSH-të

Gjatë vitit 2023 janë mbajtur 4 takime, në të cilat Komisioni për Edukim Specialistik i OMK-së, ka diskutuar lidhur me përgatitjen e një akti normativ që do të rregullonte funksionin dhe përgjegjësitë e komisionit, po ashtu janë shqyrtuar ankesat e adresuara nga anëtarët e OMK-së që janë në proces të edukimit specialistik në kuadër të institucioneve shëndetësore, si dhe shikimi i mundësive që komisioni të jetë sa më aktiv në mbikëqyrjen e ligjshmërisë së procesit të edukimit specialistik, në mënyrë që shkollimi specialistik të jetë sa më cilësor dhe të dalin kuadro të përgatitura të cilat do të hynin në sistemin shëndetësor për të ofruar shërbime shëndetësore për qytetarët.

8. Këshilli Mbikëqyrës

Gjatë vitit 2023, Këshilli Mbikëqyrës i OMK-së ka mbajtur 14 takime, ku është bërë shqyrtimi i vendimeve të Këshillit Drejtues dhe të organeve të tjera të OMK-së, ligjshmëria e tyre konform akteve juridike të OMK-së dhe ligjeve në fuqi.

9. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Gjatë vitit 2023 Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka mbajtur 14 takime, ku ka pranuar gjithsej 119 kërkesa, për të cilat ka nxjerrë 115 vendime nga të cilat 77 vendime për leje-hulumtime të reja, 28 vendime për raportet mbi përfundimin e hulumtimeve të implementuara, 4 vendime refuzuese për kërkesat e parashtruara të palëve për tu pajisur me aktin për leje-hulumtim, 4 vendime për zgjatje të afatit për implementimin e hulumtimeve në implementim e sipër, 1 vendim për ndryshimin e projektit të hulumtimit që është në implementim e sipër, si dhe 1 vendim shfuqizues për hulumtimin e aprovuar më parë, si dhe një përgjigje për prokurorin e OMK-së, sipas kërkesave të tij lidhur me implementimin e një hulumtimi pa qenë të pajisur me akt-lejtim nga Komisioni për Çështje Etike.

Sfidë e Komisionit është mos respektimi i kompetencave të këtij komisioni nga institucionet shëndetësore që iu lejojnë mjekëve dhe stafit mjekësor qasjen në protokolle mjekësore dhe histori të pacientëve e po ashtu qasje të drejtpërdrejt tek pacientët me qëllim të implementimit të ndonjë hulumtimi, pa qenë të pajisur paraprakisht me aktin për leje-hulumtim tek Oda e Mjekëve, përkatësisht Komisioni për Çështje Etike.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së

Gjatë vitit 2023, Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 12 kërkesa për përkrahje financiare. Komisioni ka nxjerrë 10 vendime për aprovimin e kërkesave të parashtruara nga palët dhe 2 vendime për refuzim të kërkesave. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke po ashtu ka shfuqizuar edhe 4 vendime të nxjerra në periudhën tetor-dhjetor 2022, të cilat i ka nxjerrë sipas detyrës zyrtare (ex-officio) për mjetet e ndara në emër të shpenzimeve të varrimit nga Fondi i Solidaritetit i OMK-së për familjet e ngushta të mjekëve anëtarë të OMK-së që kanë ndërruar jetë gjatë periudhës kohore qershor-korrik 2022 (Shënim: Mjetet e tilla ndahen konform dispozitave ligjore të Rregullores së Komisionit për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke).

11. Raporti financiar

11.1 Raporti financiar deri me 31 dhjetor 2023

1.0 Të hyrat:					
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2022	€ 810,867.00				
Total: Paraja në bankë me 31.12.2022					€810,867
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	Realizimi: TM2	Realizimi: TM3	Realizimi: TM4	Total
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:					
1.2.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 271,885	€ 92,721	€ 25,529	€ 3,895	€ 394,030
1.2.3 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 3,380	€ 3,520	€ 1,500	€ (240)	€ 8,160
1.2.2 Licencimi	€ 20,250	€ 14,130	€ 14,430	€ 12,370	€ 61,180
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,229	€ 11,777	€ 68,396	€ 83,044	€ 174,446
Të hyrat deri me 31.12.2023	€ 306,744	€ 122,147	€ 109,855	€ 99,069	€ 637,816
Paraja në bankë me 31.12.2022					€ 810,867
Total të hyrat					€ 1,448,683
2.0 Shpenzimet	Shpenzimet: TM1	Shpenzimet: TM2	Shpenzimet: TM3	Shpenzimet: TM4	Total
2.1 Paga, mëditje dhe kontributet pensionale	€ 64,310	€ 58,775	€ 57,588	€ 74,494	€ 255,167
2.2 Material shpenzues	€ 2,220	€ 2,905	€ 289	€ 1,076	€ 6,489
2.3 Reprerentacioni	€ 1,033	€ 561	€ 658	€ 641	€ 2,893
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 18,388	€ 97,035	€ 47,236	€ 100,122	€ 262,781
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 14,138	€ 12,624	€ 18,102	€ 32,493	€ 77,357
2.6 Shpenzimet e asetëve	€ 2,895	€ 1,550	€ -	€ -	€ 4,445
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 2,000	€ -	€ 3,000	€ 7,450	€ 12,450
Llogarit e pagueshme me 31.12.2022	€ 9,510				€ -
Llogarit e pagueshme me 31.12.2023	€ (10,542)	€ (6,313)		€ 1,406	€ 1,406
Total shpenzimet 31.12.2023	€ 103,951	€ 167,137	€ 126,872	€ 216,276	€ 622,988
Neto të hyrat për 2023	€ 202,793	€ (44,990)	€ (17,018)	€ (117,207)	€ 14,827
Total bilanci 31.12.2023					€ 825,694

1.2.3*Taksë administrative për aplikim për ndërrim të kartelës, regjistrimi në regjistrin e anëtarësisë së OMK-së, reregjistrim në regjistrin e OMK-së, faksimili, faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, taksa për paraqitjen e provimit, kongreset, simpoziumet, seminarët, lejimi për hulumtime për persona juridik, të ardhurat nga interesi i BKT-së, dhurata / donacione, të hyrat nga Marrëveshja për Delegim të Fondeve dhe Zbatim (DAFI KSV/017 21 2749), të ardhurat e tjera.

2.5*Faksimili, shpenzimet për botimin e revistës, organizimi i mbledhjeve të kuvendit, shpenzimet e ID kartelave të Odës, shpenzime të përkthimeve/lektorimit, mëditje për udhëtime zyrtare, trajnime për stafin, mirëmbajtja e softuerit

për financa, shpenzimet e tel., shpenzimet e int., shpenzimet e postës, pajisje të IT-së, shpenzimet bankare, shpenzimet e pastrimit, shpenzimet e transportit, shpenzimet e tjera operative.

11.2 Përkrahje për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Oda e Mjekëve të Kosovës, gjatë vitit 2023 ka ndarë përkrahje financiare në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional në vlerë totale prej 227,450.00€. Më poshtë janë pasqyruar procedurat lidhur me shpërndarjen e këtyre përkrahjeve:

Bazuar në konkursin publik të shpallur me datë 15 mars 2023 **për përkrahjen financiare të aktiviteteve të veçanta të EVP-së**, OMK ka akorduar përkrahje financiare për:

- Asociacioni i Psikiatërve të Kosovës, "Programi Vjetor i EVM-së për profesionistët e shëndetit mendor", në vlerë 2,245.00€;
- Shoqata e Mikrobiologëve të Kosovës, "Konferenca ndërkombëtare e mikroboilogëve", në vlerë 4,700.00€;
- Shoqata e Nefrologëve të Kosovës, "Terapia Renale Zëvendësuese, ringjallja e dializës peritoneale", në vlerë 5,000.00€;
- Shoqata e Neonatologëve të Kosovës, Punëtorja e UZ së trurit, në vlerë 10,000.00€;
- Shoqata e Obstetërve/Gjinekologëve të Kosovës dhe Spitali "Fati im", "Kongresi për frytnim të asistuar mjekësor - 20 vjet të punës me IVF në Kosovë", në vlerë 10,000.00€;
- Shoqata e ORL-së së Kirurgëve të Kokës dhe Qafës, "Kongresi i ORL-së", në vlerë 1,600.00€;
- Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë - PRAK, "Parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve në institucionet shëndetësore", në vlerë 4,800.00€;
- Shoqata Kosovare e Mjekëve Intensiv dhe Kujdesi Perioperator, "Kongresi ndërkombëtar i mjekimit intensiv dhe kujdesit perioperativ", në vlerë 10,000.00€;
- Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Komunën e Ferizajt, "Simpozium", në vlerë 1,800.00€;

- Shoqatën e Nefrologëve të Kosovës, “Dita botërore e veshkës”, në vlerë prej 2,500.00€.

Kongresi i V vjetor i Odës së Mjekëve të Kosovës, organizuar me datë 27-28 tetor 2023.

- Kongresi i V, “Risitë në trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare”, në vlerë prej 38,089.53€;

Përkrahje financiare për arritje shkencore dhe inovacion për vitin 2022, sipas konkursit të shpallur me datë 3 mars 2023.

- Patenta “Aparat për thithjen e lëngjeve nga trupi i kafshëve dhe i njeriut”, në vlerë prej 3,000.00€.

Përkrahje financiare për mjekët specialist të mjekësisë familjare të QKMF-së në Komunën e Prishtinës, me qëllim trajnimin e tyre për ultrasonografi si ndihmesë në diagnostikim klinik si dhe diagnostikimin diferencial klinik, sipas konkursit të shpallur me datë 1 nëntor 2023.

- QKMF Prishtinë, në vlerë prej 6,000.00€ - obligim i bartur në vitin 2024, për shkak të zgjatjes së aktivitetit deri me 31 janar 2024.

Me datë 3 mars 2023, është bërë shpallja publike **për Përkrahje financiare të punimeve shkencore** më të mira të vitit 2022. Përfitues të mjeteve ishin 11 persona, pasi që dy punimet e fundit ishin me pikë të barabarta dhe rrjedhimisht shuma e planifikuar është ndarë në dy pjesë të barabarta.

- Njëmbëdhjetë punimet shkencore më të mira të publikuara përgjatë vitit 2022, në vlerë prej 10,000.00€.

Me datë 1 qershor 2023, është bërë shpallja publike **Përkrahje të veçanta financiare të profilizimeve**, me qëllim të aplikimit të mbështetjes financiare për profilizimet e veçanta, Oda do të mbulojë 40% të shumës, por jo më shumë se 5.000,00€ për përfitues.

Profilet të cilat janë aprovuar të përkrahen janë: 2 përfitues-

Nefropatologji/Uropatologji, 2 përfitues-Hematologji, 2 përfitues-Endokrinologji Pediatrike, 2 përfitues-Gjenetikë Klinike, 2 përfitues-Neurologji Pediatrike, 2 përfitues-Gastrohepatologji, 2 përfitues-Radiologji intervente (Endovaskulare), 2 përfitues-Radiologji Pediatrike, 2 përfitues-Neurologji perinatale dhe neonatoale, 2 përfitues-Laparaskopi kirurgjike, gjinekologjike, urologjike, 2 përfitues-MRI (Radiologjia), 2 përfitues-Neurologji EEG (Pediatrike).

Janë aprovuar 24 aplikime, ku 4 prej tyre u janë alokuar mjetet në vlerë prej 16,000.00€, të cilat janë ekzekutuar bazuar në kontratat e nënshkruara 80% e vlerës në fillim të trajnimit dhe 20% e vlerës ka mbetur për tu ekzekutuar në përfundim të kontratës, rrjedhimisht të trajnimit. Ndërsa 20 përfitues nga kjo listë janë në pritje të gjetjes së institucionit adekuat për trajnim.

Gjithashtu përmes marrëveshjes ndërinstitutionale për delegim të fondeve dhe implementim mes OMK dhe projektit Luxembourg Development KSV/017 212749, janë organizuar trajnimet profesionale për mjekët e Spitalit të Përgjithshëm të Gjilanit dhe Prizrenit, në vlerë prej 143,046.46€.

11.3 Prokurimi

Gjatë vitit 2023 u zhvilluan: 14 procedura të prokurimit, ku 5 prej tyre ishin procedura të hapura të prokurimit, 2 procedura të negociuara të prokurimit, 1 procedurë një burimore dhe 6 procedura të prokurimit me vlera të vogla.

Procedura të hapura të prokurimit të zhvilluara me sukses:

1. Furnizimi i OMK-së me pajisje të teknologjisë informative.
2. Kontratë për hapësirën e mbajtjes së ceremonisë së shënimit të 10 vjetorit të themelimit të OMK-së.
3. Kontratë për hapësirën e mbajtjes së eventeve të OMK-së.
4. Kontratë për shërbime të transportit ajror.
5. Kontratë për akomodimin e të ftuarve në Ceremoninë e shënimit të 10 vjetorit të themelimit të OMK-së.

Procedura të negociuara të prokurimit të zhvilluara me sukses:

1. Kontratë për organizimin e Team building për stafin e OMK-së (financuar nga Projekti KSV/017).

2. Kontratë për dokumentarin e shënimit të 10 vjetorit të themelimit të OMK-së.

Procedura një burimore e prokurimit e zhvilluar me sukses:

1. Kontratë për vizitë një ditore në verari për të ftuarit ndërkombëtarë në shënimin e 10 vjetorit të themelimit të OMK-së.

Procedura të prokurimit me vlera të vogla të zhvilluara me sukses për:

1. Kontratë për shërbime të transportit për OMK-në.
2. Kontratë për shërbime të renovimit të zyrës së pranuar në shfrytëzim nga OMK.
3. Kontratë për furnizimin me printer multifunksional për zyrat e OMK-së.
4. Kontratë për shërbimet e trajnimit të stafit të OMK-së për përdorim të Microsoft Excel (financuar nga Projekti KSV/017).
5. Kontratë për shërbimet e vijimit të kursit të gjuhës angleze nga stafi i OMK-së (financuar nga Projekti KSV/017).
6. Kontratë për ekspozitën me temë “Mjeku ndër vite” me rastin e shënimit të 10 vjetorit të themelimit të OMK-së.

12. Aktivitete të tjera

12.1 Oda e Mjekëve të Kosovës - 10 Vite punë dhe përkushtim

Viti 2023 ka shënuar 10 vjetorin e themelimit. Me këtë rast janë organizuar një sërë aktivitetesh duke përfshirë:

- Panel diskutimi me temë “The future of self-governance within Medical Profession”.
- Shfaqjen e dokumentarit me temë “Oda e Mjekëve të Kosovës ndër vite”.
- Ekspozitën me temë “Mjeku ndër vite”.
- Publikimi i “Revista Mjeku” me numrin ceremonial me temë “10 vjetori i OMK-së”.

Në ceremoninë e 10 vjetorit të themelimit të OMK-së kanë marr pjesë përfaqësues nga Asociacioni Mjekësor Botëror, Komiteti i Përhershëm i Mjekëve të Evropës, Oda e Mjekëve të Gjermanisë, Urdhri i Mjekut të

Shqipërisë, Oda e Mjekëve të Kroacisë, Oda e Mjekëve të Malit të Zi, Oda e Mjekëve të Maqedonisë dhe përfaqësues të lartë të misionëve diplomatike në Kosovë.

12.2 Zgjedhjet për legjislaturën e III-të të OMK-së

Viti 2023 ishte vit zgjedhor për tri njësitë zgjedhore: Klinika e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës, Klinika e Reumatologjisë dhe Spitali i Përgjithshëm Vushtrri.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve së bashku me Sekretariatit në bazë të Kodit Zgjedhor kanë organizuar dhe mbajtur zgjedhjet sipas Vendimit të nxjerrë për zgjedhjet e parakohshme dhe Planit të Veprimit.

Në bazë të Planit të Veprimit janë përgatitur materialet propaguse për zgjedhjet, janë pranuar kandidaturat për përfaqësues të njërive përkatëse dhe janë certifikuar. Nga këto tri njësi janë zgjedhë tre përfaqësues të cilët janë votuar në ditën e zgjedhjeve duke fituar mandatin për legjislaturën e tretë të Kuvendit të Odës.

12.3 Kongresi i V i Mjekësisë - Risitë në trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare

Kongresi i V-të i Odës punimet i mbajti me datë 27-28 tetor 2023, ndërsa hapjen solemne e mbajti me datë 26 tetor. Në këtë ceremoni u shpërndanë mirënjohje anëtarëve të OMK-së të cilët gjatë këtij viti u pensionuan dhe dekorata post mortum për familjarët e mjekëve të cilët kanë vdekur gjatë vitit 2023.

Me 27 dhe 28 tetor në Kongresin e V-të të Mjekësisë me temën “Risitë në trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare” ligjëruan gjithsej 86 ligjërues ku 23 prej tyre ishin ligjërues të huaj ndërsa pjesa tjetër ishin vendor. Në Kongres gjithashtu janë regjistruar 1200 mjekë anëtarë të Odës dhe morën pjesë në ligjërata 963 anëtarë. Gjatë dy ditëve të punimeve të Kongresit kanë qenë 8 sesione të ndara dhe ligjërimi është bërë në 3 salla njëkohësisht. Po ashtu panairi i Kongresit u mbajt njëkohësisht në dy parahyrje të sallave ku mbaheshin punimet e Kongresit.

12.4 Botimi i “Revista Mjeku”

Oda e Mjekëve të Kosovës botoi për herë të parë “Revista Mjeku” me datë 30 mars 2021, me qëllim të informimit të publikut dhe mjekëve rreth aktualitetit në fushën e shëndetësisë, informimit të publikut rreth ofrimit të shërbimeve shëndetësore, si dhe ofrimit të reklamimit të produkteve të ndryshme mjekësore.

Revista “Mjeku” u botua 4 herë gjatë vitit 2023 dhe trajtoi temat: Kockat, Sëmundjet reumatike, 10 Vite punë dhe përkushtim, si dhe Shëndetësia jonë.

Revista është e publikuar edhe online në faqen e Odës së Mjekëve të Kosovës (linku: [REVISTA MJEKU](#)) në mënyrë që të arrijë audiencë sa më të gjerë.

12.5 Marrëveshja për Delegimin e fondeve dhe implementim

Oda e Mjekëve të Kosovës dhe projekti i Luxembourg Development KSV/017, në vitin 2022 kanë nënshkruar marrëveshje për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me ndërtimin e kapaciteteve të stafit mjekësor të Spitaleve të Përgjithshme të Gjilanit dhe Prizrenit.

Marrëveshja ka të bëjë me zbatimin e aktiviteteve të programit për trajnimin dhe zhvillimin profesional të mjekëve të spitaleve përkatëse. Program i cili është hartuar mbi planin e menaxhimit të burimeve njerëzore për periudhën 2022-2026 dhe përmes këtyre trajnimeve mjekët e këtyre spitaleve do të kenë mundësi të ngritin shkathtësitë dhe njohuritë e tyre në aspektin profesional.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje u organizuan trajnimet si më poshtë:

- Neonatologji me temë: “Reanimimi neonatal/Oksigjenoterapia te të porsalindurit” dhe “Vendosja e kateterit qendror (umbilikal);
- Ortopedi me temë trajnimi për “Ultratingull Osteomuskular”;
- Laparaskopi;
- Kardiologji intervente;
- Kirurgji e fëmijëve me temë “Teknikat kirurgjike minimale invazive tek fëmijët (Laparoskopia, Torakoskopia, Uro-gastoendoskopia), në Universitetin e Trakyas, Edirne, Turqi;

- Programi për mbështetjen e shëndetësisë në Kosovë, me fokus në Sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimin e aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të spitaleve;
- Gastroenterologji në Spitalin Murska Sobota, Slloveni;
- Sistemet e menaxhimit të cilësisë, Leadership dhe Menaxhimi i spitaleve, në spitalin Murska Sobota dhe Celje, Slloveni;
- Shërbimet e Emergjencës dhe triazhimi;
- Kardiologji;
- Gjinekologji dhe Obstetrikë në Spitalin Hayat, Turqi;
- Ortopedi në Spitalin Hayat, Turqi;
- Ortopedi në Spitalin Ortopedik Valdoltra, Slloveni;
- Radiologji intervente - endovaskulare/neurovaskulare në bazë të Planit Nacional për Stroke 2022-2025, në Spitalin Univsitar Aydin në Stamboll, Turqi.

Përfitues nga trajnimet e lartcekura janë 142 mjekë dhe infermier nga Spitali i Përgjithshëm i Prizrenit dhe Gjilanit.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur Raporti financiar nga Marrëveshja për Delegimin e Fondeve dhe Implementim.

RAPORTI FINANCIAR PËR PERIUDHËN 22.12.2022-31.12.2023						
Të hyrat e bartura nga viti 2022						125,430.68
Të hyrat kësti i tretë 03.07.2023						50,000.00
Të hyrat kësti i katërt 18.12.2023						65,733.25
Shuma totale e të hyrave 2023						241,163.93
Shpenzimet	Njësia	pax	Numri i njësive	Vlera për njësi (në euro)	Kostoja totale (në euro)	
1. Trajnime						
1.1 Ngritja e kapaciteteve të stafit						
1.1.1 Kursi i Gjuhës Angleze	persona	3	1	77.33	232.00	

1.1.2. Procedurat e Përgjithshme Administrative	persona	12	1	320.93	3,851.15
1.1.3. Burimet njerëzore	person	1	1	1400.00	1,400.00
1.1.4. Team Building	persona	7	1	714.29	5,000.00
1.1.5. Programi Microsoft Excel	persona	12	1	162.50	1,950.00
1.1.6. Trajnimi për programin e financave Quickbooks	person	1	1	424.80	424.80
Total shpenzimet të trajnimeve (Ngritja e kapaciteteve të stafit)					12,857.95

1.2 Ngritja e kapaciteteve të mjekëve					
1.2.1. Reanimacioni neonatal/oksigjenoterapi i të porsalindurve, vendosja e kateterit qendror të venave kërthizore dhe transfuzioni i të porsalindurit.	persona	32	1	939.39	30,060.51
1.2.2. Ligjërata nga menaxhmenti i spitaleve të Sllovenisë dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Partneritetit ndërmjet OMK-së, SP Gjilan, SP Prizren dhe spitaleve të Sllovenisë.	persona	30	1	319.89	10,236.55
1.2.3. Trajnime për Sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe zhvillimi i aftësive udhëheqëse dhe menaxheriale të spitaleve.	persona	3	1	4,240.99	12,722.98
1.2.4. Trajnim në fushën e Ortopedisë në Spitalin Hayat.	persona	2	1	3,725.00	7,450.00
1.2.5. Përfaqësuesit e OMK-së, SP Prizren, SP Gjilan dhe LuxDev - Vizitë në spitalet në Slloveni.	persona	5	1	1,146.53	5,732.65
1.2.6. Kardiologjia intervenuese QKUK.	persona	2	2	1,794.44	6,988.89
1.2.7. Laparoskopjia QKUK.	persona	2	4	3,777.78	7,555.55
1.2.8. Vizitë në Slloveni për Sistemet e menaxhimit të cilësisë dhe trajnimin e lidërshpimit dhe menaxhimit të spitaleve.	persona	4	1	1,512.75	6,051.00
1.2.9. Shërbimet e emergjencës dhe triazhimi.	persona	38	1	235.85	8,962.13
1.2.10 Mjekët dhe infermierët e Gastroenterologjisë SHP Prizren dhe SHGj Gjilan, Vizita e spitaleve në Slloveni.	persona	4	1	3,068.25	12,273.00
1.2.11. Ultrasonografia Osteomuskulare.	persona	6	1	1,140.00	6,840.00
1.2.12. Trajnim në fushën e Ortopedisë në Spitalin Ortopedik Valdoitra.	person	1	1	6,185.06	6,185.06
1.2.13. Trajnim në fushën e Gjinekologjisë dhe Obstetrikës në Spitalin Hayat.	persona	2	1	3,679.00	7,358.00
1.2.14. Radiologjia intervente - Endovaskulare/neurovaskulare	persona	3	3	1,110.67	3,332.00
1.2.15. Kardiologji - Mjekë dhe infermiere nga SP Celje, trajnim në SP Prizren.	persona	17	1	42.18	10058.12
1.2.16. Kardiologji intervente SP Prizren mjekët dhe infermierët, vizitë spitaleve në Slloveni - Shpenzime për vizë.	persona	3	1	161.83	485.50

1.2.17. Laparaskopi SP Prizren mjekët dhe infermierët, vizita e spitaleve në Slloveni - Shpenzime për vizë.	persona	2	1	164.50	329.00
1.2.18. Shpenzime bankare për trajnime.					462.80
Shpenzimet totale për trajnime (Ngritja e kapaciteteve të mjekëve)					143,083.74
Shpenzimet totale të trajnimeve					155,941.69
2. Pajisjet, furnizimet dhe inventari					
2.1. Kompjuter dhe pajisje tjera të teknologjisë informative	njësi	1	5	523.40	2,617.00
2.2. Shpenzime të tjera (komision bankar, shpallje thirrjesh publike)	njësi	1	1	442.90	442.90
Shpenzimet totale për pajisje të furnizimeve dhe inventar					3,059.90
SHPEZIMET TOTALE 31.12.2023					159,001.59
TOTAL BILANCI 31.12.2023					82,162.34

12.6 Ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së

Në kuadër të marrëveshjes për delegimin e fondeve dhe implementimin e aktiviteteve, është e përfshirë edhe ngritja e kapaciteteve të shërbimit profesional të OMK-së.

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje u organizuan trajnimet si më poshtë:

- Trajnimi për programin Microsoft Excel;
- Kursi i Gjuhës Angleze;
- Team Building;
- Burimet njerëzore;
- Procedurat e përgjithshme administrative;
- Trajnimi për programin e financave Quickbooks.

12.7 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale dhe në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional lidhur me veprimtarinë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga gjykatat

dhe prokuroritë publike të Kosovës, ka caktuar ekspertë apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësive profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës. Ekspertiza të tilla kanë qenë në shërbim të konstatimit të përgjegjësive individuale të mjekëve të cilët i janë nënshtruar procedurave penale apo civile, qoftë në fazën hetimore apo gjatë shqyrtimeve gjyqësore.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për vitin 2023	Vendimet sipas urdhëresave së pranuar për vitin 2023	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për vitin 2023	Lëndët e bartura nga periodat paraprake
Kryetari i Odës	20	18	10	11	3

12.8 Marrëdhëniet ndërkombëtare

Mbledhja e Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve (CPME)

Përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morën pjesë në punimet e takimit të radhës së Komitetit të Përhershëm Evropian të Mjekëve.

Nikoqiri i këtij takimi ishte Oda e Mjekëve të Kroacisë. Temat e diskutimit gjatë mbledhjes ishin:

- Shëndetësia digjitale;
- Praktika profesionale dhe sistemet shëndetësore;
- Parimet, pacientët dhe etika;
- Praktika profesionale dhe sistemi shëndetësor;
- Shëndeti publik dhe parandalimi i sëmundjeve;

Temë e diskutimit në takim ka qenë edhe dhuna ndaj mjekëve dhe profesionistëve të tjerë shëndetësor në shtetet evropiane. Sipas raportimeve nga shoqatat mjekësore në Evropë është rritur dhuna verbale dhe fizike. CPME inkurajon mjekët të raportojnë aktet e dhunës ndaj mjekëve dhe profesionistëve

shëndetësor, ku gjithashtu duhet aplikuar një politikë zero tolerance ndaj dhunës në vendin e punës.

Gjatë këtij eventit u zhvilluan takime në mes të përfaqësuesve të OMK-së, odave dhe shoqatave të mjekëve evropian lidhur me bashkëpunimin e mundshëm në fushat e interesit që ju takojnë.

Komiteti i Përhershëm Evropian i Mjekëve është institucion ndërkombëtar me ndikimin në politikbërje në nivel evropian dhe ka një rëndësi të madhe në rregullimin e sektorit shëndetësor në nivel të vendeve të Bashkimit Evropian, ku pas të gjitha takimeve të mbajtura konkluzat e takimit i dërgohen Komisionit Evropian për reformimin dhe rregullimin e politikave shëndetësore.

Oda e Mjekëve të Kosovës është anëtare vëzhguese në këtë organizatë që nga viti 2018, ku deri më tani ka marrë pjesë në të gjitha takimet e organizuara.

Asambleja e Odës së Mjekëve të Gjermanisë

Përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morën pjesë në Asambleenë e Odës së Mjekëve të Gjermanisë.

Temat e diskutimit gjatë mbledhjes u fokusuan në çështje të rëndësishme të politikave dhe reformave që prekin sektorin e shëndetësisë si dhe zhvillimet e fundit në këtë sektor, ku ndër pikat kryesore të diskutimit ishin “Edukimi shëndetësor: Nga dija në veprim” dhe “Liria dhe përgjegjësia në profesionin e mjekut”.

Takimi i 37 vjetorit të Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore

Përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morën pjesë në takimin e 37 vjetorit të Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore. Nikoqir i takimit të 37 vjetorit të Forumit Evropian të Shoqatave Mjekësore ishte Oda Polake e Mjekëve dhe Stomatologëve, e që u organizua në Varshavë. Temat kryesore që u trajtuan në këtë takim ishin:

- Mjekësia në kohën e konflikteve;
- Migrimi i fuqisë punëtore të kujdesit shëndetësorë;
- Kujdesi shëndetësor për refugjatët dhe rehabilitimi.

Simpoziumi i 29 i ZEVA (Odave të Mjekëve të Evropës Qendrore dhe Lindore)

Në shtator 2023, përfaqësues të Odës së Mjekëve të Kosovës morën pjesë në Simpoziumin e përvitshëm të ZEVA-së.

Nikoqiri i këtij takimi ishte Oda e Mjekëve të Gjermanisë, ku temat e diskutimit ishin të fokusuar në studimet bazike mjekësore dhe sigurimi i cilësisë në ngritjen e nivelit të shkollimit mjekësor, mungesa e mjekëve në shtete e ndryshme si dhe plani për tu rritur numri i studentëve të mjekësisë, mundësitë dhe sfidat e profesioneve të reja të asistencës mjekësore si dhe mjekësia komplementare dhe ajo alternative, ku pjesë e këtyre diskutimeve ishte edhe përfaqësuesi i Odës në prezantimin e raporteve rreth këtyre temave.

Simpoziumi i ZEVA-së është një takim i përvitshëm i cili siguron një forum për përfaqësuesit e odave të mjekëve nga rajoni i Evropës Qendrore dhe Lindore për të përmbushur dhe diskutuar çështje që shqetësojnë reciprokisht. Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe temat e takimit të ardhshëm të ZEVA-së, ku në mesin e shumë odave konkurrense për ta mbajtur takimin e ardhshëm, duke ju falënderuar lobimit të përfaqësuesve nga Oda e Mjekëve të Kosovës, u njoftua se takimi i radhës do të mbahet dhe organizohet në Kosovë.

13. Plani i veprimit për 2024

- Fillimi i zbatimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të.
- Fillimi i zbatimit të sistemit informativ/bazës interaktive të të dhënave, ku do të përfshihen të gjitha proceset e OMK-së.
- Organizimi i simpoziumit të përvitshëm ZEVA 2024.
- Organizimi i Kongresit të VI me temë “Diagnostika paraklinike”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK dhe SHSKUK.

- Vazhdimi i zbatimit të Marrëveshjes për Delegimin e Fondeve dhe Implementim projekti KSV/017-21 2749.
- Hulumtim për vlerësimin e ngarkesës së sëmundjes kronike dhe sindrominit burnout (shpenzimi profesional i mjekëve).
- Organizimi i tryezës së rrumbullakët me temë “Implementimi i kornizës legislative në shëndetësi me fokus odat”.